



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES**



VENDIM

Nr. 6 Date 12/02/2013

PER

**PAGESEN E KUOTES SE ANETARSIMIT NE ASAMBLENE EUROPIANE TE
RAJONEVE (AER)**

Këshilli i Qarkut Kukës në mbledhjen e tij të datës së mësipërme, pas shqyrtimit të Relacionit dhe P/vendimit të paraqitur nga Keshilltari i M. me Jashtë, bazuar në nenin 109/4 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/V/b, 19 dhe 54, ligjit Nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjin Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore" neni 10, VKM Nr.228 date 23.04.2004 "Per rregullimin e marrëdhënieve me jashtë të administratës shtetërore", ligjin Nr. 119/2012 miratuar me date 17.12.2012 "Per buxhetin e vitit 2013", ligjin Nr.9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", udhezimin e Ministrisë së Financave Nr.2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", si dhe kërkeses së bërë nga AER date 05.11.2012,

VENDOSI:

1. Të miratojë shumën prej 3099,00 € (Euro) si pagesë e kuotës së anetarsimit në Asambleenë Rajonale të Europës (AER) për vitin 2013.
2. Të autorizojë Zyren e Financës pranë Këshillit të Qarkut Kukës që të bëjë pagesën e kuotës vjetore të anetarsimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Këshillit të Qarkut Kukës, Drejtorja e Financës si dhe Keshilltari për Marrëdhëniet me Jashtë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc: E.Hasa

Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B.Ngjeçi



KRYETARI

Ibsen ELEZI

U hartua në 3 (tre) kopje origjinale:

1. Zyres së Protokoll Arkivit
2. Institucionit të Prefektit të Qarkut